



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.49

11 prill

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.303, datë 12.3.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, të ndryshuar	2197
Vendim i KM nr.304, datë 12.3.2008	Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2008, për Entin Rregullator të Telekomunikacioneve	2197
Vendim i KM nr.305, datë 12.3.2008	Për përballimin e shpenzimeve të atashëve ushtarakë, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që shërbejnë në shtabet e NATO-s e në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, dhe të ushtarakëve shqiptarë, që shërbejnë pranë organizatave ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare	2198
Vendim i KM nr.308, datë 12.3.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Tërbuf të qarkut të Fierit	2200
Vendim i KM nr.309, datë 12.3.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Sllabinjë 2”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	2202
Vendim i KM nr.310, datë 12.3.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Murdhari 1”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	2203

Vendim i KM nr.311, datë 12.3.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Qukës”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë..	2203
Vendim i KM nr.312, datë 12.3.2008	Për tjetërsimin e pronësisë shtetërore të truallit dhe mjediseve të ndërmarrjes elektroteknike, Tiranë, nga pronë shtetërore në pronë private, për shoqërinë “Erjoni” sh.p.k. Tiranë	2204
Vendim i KM nr.313, datë 12.3.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.370, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të administratës së prefektit”, të ndryshuar	2204
Vendim i KM nr.314, datë 12.3.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Rrashbull të qarkut të Durrësit	2205
Vendim i KM nr.319, datë 19.3.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike të importuar nga KESH sh.a.”, të ndryshuar	2207
Vendim i KM nr.320, datë 19.3.2008	Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale	2207
Vendim i KM nr.322, datë 19.3.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Margegaj të qarkut të Kukësit	2211
Vendim i KM nr.323, datë 19.3.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Bubullimë të qarkut të Fierit	2212
Vendim i KM nr.325, datë 19.3.2008	Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtareve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë.....	2213
Vendim i KM nr.326, datë 19.3.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Kozarë të qarkut të Beratit	2224
Vendim i KM nr.327, datë 19.3.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Margegaj të qarkut të Kukësit	2226
Vendim i KM nr.328, datë 19.3.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Qendër Malësi e Madhe të qarkut të Shkodrës	2231

VENDIM
Nr.303, datë 12.3.2008

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.475, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E
PRESIDENTIT, KUVENDIT DHE KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr.3, që i bashkëlidhet vendimit nr.475, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, për Ministrinë e Brendshme, pas pozicionit “Koordinator në Njësinë Antitrafik”, të shtohen edhe këto pozicione:

- “ a) Drejtor i njësisë së zhvillimit të prokurimeve të përqendruara, II-a;
- b) Koordinator në njësinë e zhvillimit të prokurimeve të përqendruara, III-a.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 4 shkurt 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.304, datë 12.3.2008

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2008, PËR ENTIN
RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 87 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2008, për Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, në shumën 237 182 138 (dyqind e tridhjetë e shtatë milionë e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë, të ndarë sipas zërave, të paraqitura në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA E FONDIT TË SHPENZIMEVE TË ENTIT RREGULLATOR TË
TELEKOMUNIKACIONEVE PËR VITIN 2007

Nr.	Emërtimi	Lekë
	Shpenzime gjithsej:	237 182 138
1.	Paga	56 869 910
2.	Kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore	9 618 228
3.	Materiale	4 000 000
4.	Shërbime	31 730 000
5.	Investime	134 964 000

VENDIM
Nr.305, datë 12.3.2008

**PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË ATASHEVE USHTARAKË, TË
USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, QË SHËRBEJNË NË SHTABET E
NATO-S E NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË
NATO-S, DHE TË USHTARAKËVE SHQIPTARË, QË SHËRBEJNË PRANË
ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE
NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, brenda fondeve buxhetore vjetore, të përballojë shpenzimet e atasheve ushtarakë, të akredituar në vende të tjera, të ushtarakëve, që shërbejnë në përfaqësinë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që shërbejnë në shtabet e NATO-s, dhe të ushtarakëve shqiptarë, që shërbejnë pranë organizatave ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, për:

- a) shpenzimet publicitare, në interes të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
- b) shpenzimet për udhëtime dhe dieta jashtë vendit pritës, kur këto kryhen në interes të Ministrisë së Mbrojtjes;
- c) shpenzimet për pritje të partnerëve zyrtarë, në vendin pritës;
- ç) shpenzimet për ceremoni zyrtare, të karakterit ushtarak, në vendin pritës;
- d) shpenzimet për pritje të personelit ushtarak, të nivelit të lartë;
- dh) shpenzimet për udhëtime dhe dieta, brenda vendit pritës;
- e) shpenzimet për mbështetjen e veprimtarive, veçanërisht të rëndësishme, të studentëve ushtarakë shqiptarë, në vendet përkatëse;
- ë) shpenzimet për uniformën;
- f) shpenzimet për qira apartamenti dhe mirëmbajtje;
- g) shpenzimet për pajisje shtëpiake;
- gj) shpenzimet për blerje automjeti, siguracion, mirëmbajtje;
- h) shpenzimet për karburant;
- i) shpenzimet për siguracion shëndetësor familjar;
- j) shpenzimet për taksa të shkollave publike, komisione bankare.

Kriteret, specifikimet dhe rastet e përballimit të shpenzimeve, të përcaktuara në shkronjat “e”, “g”, “gj” dhe “h” të kësaj pike, përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

2. Kur ushtaraku dërgohet me shërbim jashtë venddislokimit të komandës ose kur vjen në atdhe, por në shtetin ku kryen detyrën ka lënë bashkëshorten dhe fëmijët, ka të drejtë të marrë 100 për

qind të trajtimit financiar, që është për përkujdesje ndaj familjes.

3. Kur ushtaraku shtrohet për kurim në institucionet shëndetësore të shtetit, ku ndodhet komanda apo shtabi i NATO-s ose në ndonjë shtet tjetër, ai vazhdon ta përfitojë pagën përkatëse dhe trajtimin financiar, që është për përkujdesje ndaj familjes.

4. Ushtaraku gëzon të drejtën e pushimeve javore, pushimeve në ditët e festave zyrtare dhe pushimin vjetor të paguar, për kohën që është me detyrë jashtë shtetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi, në Republikën e Shqipërisë. Ministria e Mbrojtjes nuk merr përsipër shpenzimet për ushtarakun, kur ai kthehet në atdhe, për të bërë lejen e zakonshme. Me miratimin e Ministrit të Mbrojtjes, për raste të veçanta (vetëm për fatkeqësi), për ushtarakun dhe familjarët shoqëruar paguhen nga shteti vetëm shpenzimet e udhëtimit (për ardhje në atdhe dhe kthimin në vendin e huaj).

5. Ministria e Mbrojtjes për këta ushtarakë dhe pjesëtarët e familjes, që janë në ngarkim të tij, bën sigurimet e detyrueshme, sipas legjislacionit të shtetit përkatës, ku ata kryejnë detyrën. Ushtaraku aktiv dhe pjesëtarët e familjes, në ngarkim të tij, kanë të drejtë që, për raste urgjencash, të mjekohen në vendin, ku ushtaraku kryen detyrën, me miratimin e eprorit direkt dhe sipas rregullave të shtabit, ku ai bën pjesë, kur për një gjë të tillë nuk është parashikuar sigurimi shëndetësor. Në këtë rast, shpenzimet përballohen nga shteti, ndërsa për rastet e tjera, shpenzimet përballohen nga vetë ushtaraku.

6. Ushtaraku ka të drejtë të marrë shpenzime udhëtimi, akomodimi dhe diete, në valutë të huaj, sipas legjislacionit në fuqi, kur nga drejtuesi emërohet në detyrë, thirret në atdhe ose dërgohet me shërbim në një shtet tjetër, kthehet në atdhe në përfundim të misionit, si dhe dërgohet me shërbim, për nevoja pune, nga autoritetet drejtuese të NATO-s.

Për rastet e parashikuara në këtë pikë, personeli, që mban gradë madhore, merr dietë të kategorisë së parë, personeli, që mban grada të larta, merr dietë të kategorisë së dytë dhe personeli, që mban grada të ulëta, si dhe personeli nënoficer e ushtar, marrin dietën e kategorisë së tretë. Kur ushtaraku shoqërohet nga bashkëshortja, kjo e fundit trajtohet me të njëjtën dietë si bashkëshorti.

7. Vendimi nr.155, datë 13.3.2003 i Këshillit të Ministrave “Për përballimin e shpenzimeve të atasheve ushtarakë dhe oficerëve të Forcave të Armatosura, që shërbejnë në shtabet e NATO-s”, të ndryshuar, shfuqizohet.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

9. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.308, datë 12.3.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA TËRBUF TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001

“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Tërbuf të qarkut të Fierit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 13 (trembëdhjetë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Tërbuf për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE										
Komuna: Tërbuf										
Fusha e përdorimit të pronës: Pyll										
Nr. rend	Nr.i inv.sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësitë administrative	Institucioni, enti përdorues statusi juridik i përdorimit	Të dhëna (Shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1.	914	Çermë Taçez	„	4÷21	Sip.boshe	165	Prodhues	M.M.P.A.U	D.Sh.P	
2.	915	Shelgu e Gjekos	Shelgu i Gjekos	22/a	L.P+D.Z	5.76	„	„	„	
3.	916	„	„	23/a	Boshte	8	„	„	„	
4.	917	„	„	23/b	„	10.8	„	„	„	
5.	918	„	„	24/a	„	2	„	„	„	
6.	919	„	„	24/b	„	2	„	„	„	
7.	920	„	„	24/c	„	3.64	„	„	„	
8.	921	„	„	25/a	„	1.52	„	„	„	
9.	922	„	„	26/a	„	4.12	„	„	„	
10.	923	Shelgu i Mesëm	Shelgu i Mesëm	27/a	L.P+D.Z	15	„	„	„	
11.	924	Kular	Kular	28/a	Boshe	4.2	„	„	„	
12.	925	„	„	29/a	L.P+D.Z	11.84	„	„	„	
13.	926	„	„	29/b	Boshe	0.92	„	„	„	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
914-926	Pyll	Pronësi

VENDIM
Nr.309, datë 12.3.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “SLLABINJË 2”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Sllabinjë 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 5 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “LNK” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Sllabinjë 2”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.310, datë 12.3.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “MURDHARI 1”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT,
NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Murdhari 1”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 4 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Euro-Al” sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Murdhari 1”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.311, datë 12.3.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “QUKËS” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Qukës”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 5 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Shopi” sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Qukës”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.312, datë 12.3.2008**

**PËR TJETËRSIMIN E PRONËSISË SHTETËRORE TË TRUALLIT DHE MJEDISEVE TË
NDËRMARRJES ELEKTROTEKNIKE, TIRANË, NGA PRONË SHTETËRORE NË PRONË
PRIVATE, PËR SHOQËRINË “ERJONI” SHPK, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 757-760 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 3, shkronja “b”, e 8 paragrafi i parë të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, dhe të neneve 4, 5, 10, 11, 12 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tjetërsimin e pronësisë shtetërore të truallit dhe të ndërtesës 2-katëshe, me tulla silikate, të ndërmarrjes elektroteknike, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 2209 m², sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, nga pronë shtetërore në pronë private, për shoqërinë “Erjoni” sh.p.k. Tiranë.

2. Pagimi i çmimit nga shoqëria “Erjoni” sh.p.k. Tiranë, do të bëhet në natyrë, me sipërfaqe të lirë trualli, që ka në pronësi kjo shoqëri, bazuar në krahasimin e vlerave të objekteve, të vlerësuara në shkëmbim, dhe në para, në shumën 14 230 560 (katërmëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

3. Pronësia e ndërtesës dykatëshe, së bashku me truallin nën to, të kalojnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit të shoqëria “Erjoni” sh.p.k., përmes një kontrate tjetërsimi mbi pasuritë e paluajtshme, nënshkruar nga të dyja palët, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Metrologjisë dhe Kalibrimit për ta nënshkruar kontratën e shkëmbimit, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.313, datë 12.3.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.370, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.370, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Nënprefekt i Kavajës, Lushnjës dhe Sarandës

87 000 lekë.”.

ii) Në shkronjën “ç”, emërtesa “Sarandë” shfuqizohet.

b) Në kolonën 1 të lidhjes nr.1, emërtimi në nënndarjen e dytë, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Sekretar i përgjithshëm në nënprefekturat Kavajë, Lushnjë, Sarandë.”.

2. Efektet financiare, për vitin 2008, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, për institucionin e nënprefektit, Sarandë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

VENDIM
Nr.314, datë 12.3.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA RRASHBULL TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Rrashbull të qarkut të Durrësit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 12 (dymbëdhjetë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Rrashbull për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU										
Komuna: Rrashbull										
Nr. ren.	Nr. i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullimore (EPK), shtrirja gjeografike e EPK-së	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1.	63	Bozanxhie	Bozanxhie	26b	Boshe	14.5		MMPAU	DSHP Durrës	
2.	64	Shkallnuer	Pylli i Vargjeve	27	Pyll prodhues	5	Dru zjarri	MMPAU	DSHP Durrës	
3.	65	Shkallnuer	Pylli i Kertecit	28a	Pyll prodhues	7.5	Dru zjarri	MMPAU	DSHP Durrës	
4.	66	Shkallnuer	Pylli i Kertecit	28b	Boshe	1.5		MMPAU	DSHP Durrës	
5.	67	Shijak Maminas	Faqja Prroit Madh	4	Kullotë	23.1	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	Kaluar me VKM nr.700, datë 23.10.95
6.	68	Romanat	Gryka e Skiles	5	Kullotë	49.8	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
7.	69	Manskuri	Kodra Dushkut	6	Kullotë	57.8	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
8.	70	Manskuri(lagjja Veze)	Djerri Prroit Madh	7	Kullotë	55.2	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
9.	71	Manskuri(lagjja Gjuzaj)	Faqja Gjuzaj	9	Kullotë	44.4	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
10.	72	Shkallnuer(lagjja Vargje)	Shkallmuer	10	Kullotë	85.7	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
11.	73	Shkallnuer	Faqja Memaj	11	Kullotë	49	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	
12.	74	Manskuri(lagjja Tusha)	Faqja Memaj	12	Kullotë	72.7	Kullotë fshati	MMPAU	DSHP Durrës	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
63-74	Pyll, kullotë	Pronësi

VENDIM
Nr.319, datë 19.3.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.559, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SKEMËN E SHTYRJES SË PAGESËS SË TVSH-SË PËR MAKINERITË DHE PAJISJET E IMPORTUARA, SI DHE ENERGJINË ELEKTRIKE TË IMPORTUAR NGA KESH SHA ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun I të vendimit nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3.2, fjalët “Pagesa e TVSH-së shtyhet deri në gjashtë muaj nga kryerja e zhdoganimit.”, zëvendësohen me “Pagesa e TVSH-së shtyhet deri në dymbëdhjetë muaj nga kryerja e zhdoganimit.”.

2. Në pikën 5, fjalët “...brenda gjashtë muajve nga çasti i importimit të makinerive dhe të pajisjeve ...” zëvendësohen me “...brenda dymbëdhjetë muajve nga çasti i importimit të makinerive dhe të pajisjeve...”.

3. Në shkronjën “a” të pikës 7, fjalët “...brenda gjashtë muajve nga çasti i kryerjes së importit...” zëvendësohen me “...brenda dymbëdhjetë muajve nga çasti i kryerjes së importit...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.320, datë 19.3.2008

PËR SISTEMIN E IDENTIFIKIMIT TË KAFSHËVE DHE TË REGJISTRIMIT TË FERMAVE BLEGTORALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pikat 6, 7, 38 e 39, 24, shkronja “b”, e 32, pika 6 të ligjit nr.9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar”, dhe të nenit 4 të ligjit nr.8702, datë 1.12.2000 “Për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti përgjegjës për regjistrin kombëtar të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale është drejtoria, që mbulon fushën e veterinarisë, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij autoriteti përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Për qëllimet e këtij vendimi, termat e mëposhtme kanë këtë kuptim:
“Fond kundërparti”, fondi i krijuar nga pagesat e fermerëve, për bazën materiale të sistemit të identifikimit të kafshëve, dhe që përdoret për blerjen, në vazhdimësi, të materialeve, për funksionimin e këtij sistemi.

“Operator privat”, personi i kontraktuar nga sektori veterinar i drejtorisë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, për zbatimin në terren të sistemit të identifikimit të kafshëve.

3. Drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit (sektori veterinar) drejtojnë dhe zbatojnë, për çdo zonë që mbulojnë, sistemin e identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale, nëpërmjet specialistëve privatë, veterinerë dhe zooteknikë, me të cilët lidhin kontratat përkatëse.

4. Kostoja financiare e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale, për pagesën e bazës materiale dhe për shërbimin e kryer nga operatorët privatë mbulohet nga buxheti i këtij viti, miratuar për këtë qëllim, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Paga për operatorët privatë bëhet nga buxheti i matrikullimit, i planifikuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për vitin 2008, për drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në qarqe, si më poshtë vijon:

a) për gjedhin, 90 (nëntëdhjetë) lekë, për çdo kafshë të matrikulluar;

b) për bagëtitë e imta, 20 (njëzet) lekë, për çdo kafshë të matrikulluar me matrikull individual, dhe 5 (pesë) lekë për krenrë, për matrikullimin e kafshëve të reja, me destinacion për therje.

Në shërbimin e kryer nga operatori privat përfshihen matrikullimi i kafshës dhe plotësimi e dorëzimi i formularëve respektivë në drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, ku janë të kontraktuar.

6. Fondi kundërparti, i krijuar deri në fund të vitit 2007 “Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale”, të përdoret për blerjen, në vazhdimësi, të materialeve për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe për regjistrimin e fermave blegtorale, sipas udhëzimit përkatës të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

7. Organet e qeverisjes vendore, Policia e Shtetit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave bashkëpunojnë dhe mbështesin drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit për zbatimin e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale dhe për kontrollin e lëvizjes së kafshëve, sipas udhëzimit përkatës të këtyre institucioneve.

8. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

9. Vendimi nr.390, datë 21.6.2006 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
DPSUMK

Nr.....prot

Tiranë, më2007

PASQYRA E SHPENZIMIT TOTAL PËR PROCESIN E IDENTIFIKIMIT TË
GJEDHIT DHE REGJISTRIMIT TË FERMAVE BLEGTORALE

Baza materiale

1. Instalim programi (software + licencë + instalim)	7 500 000	lekë
2. Kompjuter + server (26 rrethe)	4 400 000	lekë
3. Printer (26 rrethe)	300 000	lekë
4. UPS (26 rrethe)	1 500 000	lekë
5. Toner, CD etj.	400 000	lekë
6. Telefon	500 000	lekë
SHUMA	14 600 000	lekë

Matrikullimi

Matrikuj për 300 000 krerë * 150/krerë	45 000 000	lekë
Punë veterinare 390000 krerë * 90/krerë	35 100 000	lekë
SHUMA	80 100 000	lekë

Trajnime*	2 200 000	lekë
Promocion	1 500 000	lekë
Të tjera	100 000	lekë
SHUMA	3 800 000	lekë

*(Trajnimet 30 specialistë * 5 ditë * 4000/ personi	600 000	lekë
200 specialistë *2 ditë * 4000/personi)	1 600 000	lekë
Fond rezervë	1 500 000	lekë

TOTALI	100 000 000	lekë
--------	-------------	------

**KALENDARI I AKTIVITETEVE NË 29 RRETHET QË NUK JANË PËRFSHIRË MË PARË NË PROCESIN E IDENTIFIKIMIT
TË KAFSHËVE DHE REGJISTRIMIT TË FERMAVE BLEGTORALE**

Nr.	EMËRTIMI	Afati kohor (muaj)											
		J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH
1	Përgatitja e kuadrit ligjor të nevojshëm (VKM, urdhër ministri)												
2	Përgatitja e termave dhe kriterëve për tenderimin e bazës materiale (matrikuj dokumentacioni, baza kompjuterike)												
3	Kryerja e tenderit												
4	Përcaktimi i termave të referencës për përgatitjen e software e të dhënave për sistemin (programi kompjuterik i data base)												
5	Kryerja e tenderit												
6	Trajnimi për inspektorët veterinarë dhe veterinerët praktikë që do të përfshihen në proceset operative (29 rrethe)												
7	Ardhja e bazës materiale												
8	Shpërndarja e bazës materiale												
9	Përfundimi i software dhe instalimi në 36 rrethe												
10	Trajnime për specialistët që do të hedhin të dhënat në data base-n përkatës (për çdo rreth)												
11	Matrikullimi i kafshëve dhe regjistrimi i fermave												
12	Monitorimi i aktiviteteve												

**KALENDARI I AKTIVITETEVE NË 7 RRETHET QË JANË PËRFSHIRË MË PARË NË PROCESIN E IDENTIFIKIMIT TË KAFSHËVE
DHE REGJISTRIMIT TË FERMAVE BLEGTORALE**

Nr.	EMËRTIMI	Afati kohor (muaj)											
		J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH
1	Matrikullimi i kafshëve dhe regjistrimi i fermave (vazhdim)												
2	Trajnimi për inspektorët veterinarë dhe veterinerët praktikë që do të përfshihen në proceset operative (29 rrethe)												
3	Trajnime për specialistët që do të hedhin të dhënat në data base-n përkatës (për çdo rreth)												
4	Monitorimi i aktiviteteve												

VENDIM
Nr.322, datë 19.3.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS MARGEGAJ TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Margegaj të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Margegaj të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr. 17, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Margegaj”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Margegaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna: Margegaj

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
89-92	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
94-101	Varreza publike	Në pronësi
25,26,30,36,39	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
135-141	Infrastrukturë (Sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
14-24,28,29,31-35,37,38,40-47,78	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
48-50,52-55,57,58,60,61,63,64,66,67,69,70,72,73	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
51,56,59,62,65,68,71	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
145,146-149	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.323, datë 19.3.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS
BUBULLIMË TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Bubullimë të qarkut të Fierit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Bubullimë të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.649, datë 30.9.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bubullimë”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Bubullimë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Komuna: Bubullimë

Lidhja 1

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
13-19	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore sportive	Në pronësi
20-26	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
27-29,31-46	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës	Në pronësi
47-55	Shërbim funeral	Në pronësi
19,20	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
30,207	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje)	Në përdorim
56,96	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
210-212,215-229	Infrastrukturë (rrugë vendore lulishte, trotuar)	Në pronësi
208,209	Furnizim me ujë të pijshëm	Në pronësi
97/1,98/1,99/1,101,102,107/ 1,104,106,108,131,142,152, 161,173,190,191,206	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive kanale të treta)	Në pronësi
97,98,99,100,103,105,107	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim

VENDIM

Nr.325, datë 19.3.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PRANIMIN NË VEPRIMTARINË E OPERATORIT
TË TRANSPORTIT RRUGOR TË MALLRAVE DHE TË UDHËTARËVE, SI DHE PËR**

NJOHJEN E DOKUMENTEVE ZYRTARE, TË CAKTUARA PËR KËTA OPERATORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 43 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe të neneve 83 e 87 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

RREGULLAT

PËR PRANIMIN NË VEPRIMTARINË E OPERATORIT TË TRANSPORTIT RRUGOR TË MALLRAVE DHE UDHËTARËVE, SI DHE NJOHJA E DOKUMENTEVE ZYRTARE TË CAKTUARA PËR KËTA OPERATORË

KAPITULLI I

QËLLIMI DHE FUSHA E VEPRIMIT TË RREGULLAVE

1. Qëllimi

1.1 Pranimi dhe ndjekja e veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor të mallrave ose operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve rregullohet me anën e dispozitave të këtij vendimi.

1.2 Dispozitat e këtij vendimi do të zbatohen për të gjitha ndërmarrjet e transportit rrugor, që përfshihen në:

- a) veprimtarinë e transportit rrugor të udhëtarëve, për të tretë ose me qira, brenda dhe jashtë vendit;
- b) veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave, për të tretë ose me qira, me mjete motorike ose kombinimi të mjeteve, kapaciteti i të cilave përcaktohet me udhëzim të ministrit, sipas nenit 49 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar;
- c) veprimtarinë e transportit rrugor të mallrave, për të tretë ose me qira, brenda vendit, me mjete motorike ose kombinimi të mjeteve, kur ngarkesa maksimale e lejuar kalon 1.5 tonë.

2. Shtrirja

2.1 Transporti i mallrave dhe udhëtarëve lejohet të kryhet, nga ndërmarrje të transportit, për të tretë ose me qira, vetëm kur janë pajisur me:

- a) licencën përkatëse në transportin rrugor, për të tretë ose me qira, të mallrave ose udhëtarëve, brenda vendit;
- b) licencën përkatëse në transportin ndërkombëtar rrugor, për të tretë ose me qira, të mallrave ose udhëtarëve.

2.2 Përfshihet nga rregullimi i pikës 2.1 të këtij kapitulli, lejohet transporti i mallrave dhe i udhëtarëve, nga ndërmarrje të transportit, për të tretë ose me qira, për rastet në vijim:

- a) për kategoritë e operacioneve të transportit të mallrave për të tretë ose me qira brenda vendit, që mund të kryhen pa licencë sipas nenit 44 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar;
- b) për disa kategori transporti ndërkombëtar të mallrave, kur e parashikojnë marrëveshjet ndërkombëtare;
- c) kur leja e përkohshme, për vazhdimin e operacionit të ndërmarrjes, është dhënë për qëllime të rrethanave të paparashikuara, si në rastin e fatkeqësive natyrore, ose kur këtë e kërkojnë ndërtimet masive brenda qytetit, ose kur e kërkojnë punët e bujqësisë në kohën e korreve dhe shirjeve.

2.3 Përfshihet nga dispozitat e këtij vendimi:

- a) ndërmarrjet, që kërkojnë të përfshihen në operacionet e transportit të udhëtarëve për llogari të

vet. Në këtë rast, operacionet e transportit kryhen për qëllime jotregtare dhe jofitimprurëse, si dhe mjetet e përdorura janë pronë e ndërmarrjes ose të marra me qira dhe drejtohen nga punonjësit të ndërmarrjes;

b) ndërmarrjet e transportit të mallrave për llogari të vet. Në këtë rast, mallrat e transportuara janë pronë e ndërmarrjes, si dhe mjetet motorike për transporte të tilla drejtohen nga punonjësit e ndërmarrjes dhe janë pronë e ndërmarrjes, ose janë të blera nga ajo me këste, ose të marra me qira pa drejtues mjeti. Transporti i mallrave për llogari të vet duhet të jetë ndihmës në të gjitha veprimtaritë e ndërmarrjes.

KAPITULLI II

PLOTËSIMI I KUSHTEVE PËR PRANIMIN NË VEPRIMTARINË E TRANSPORTIT RRUGOR

1. Kërkesat për pranim

Licenca për pranimin në veprimtarinë e transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve jepet për operatorët e transportit rrugor, kur plotësohen kërkesat si më poshtë vijon:

- a) të jetë me reputacion të mirë;
- b) të ketë besueshmëri financiare;
- c) të ketë kompetencën profesionale të nevojshme.

2. Drejtuesi i veprimtarisë së transportit

2.1 Ndërmarrja që përfshihet në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor, duhet të ketë në përbërje të saj ose të punësuar me kontratë një ose më shumë persona, që drejton veprimtarinë e saj, por që duhet të plotësojë kërkesat sipas shkronjave “a” dhe “c” të pikës 1 të këtij kapitulli. Drejtuesi i veprimtarisë së transportit, duhet të plotësojë kushtet, si më poshtë vijon:

- a) ai/ajo duhet të drejtojë efektivisht dhe vazhdimisht veprimtarinë e transportit të ndërmarrjes;
- b) të jetë i punësuar dhe i paguar nga ndërmarrja ose, kur ndërmarrja është një person fizik, mund të jetë vetë ky person.

2.2 Kur ndërmarrja është person fizik dhe nuk plotëson kërkesën e shkronjës “c” të pikës 1 të këtij kapitulli, organet e transportit, sipas nenit 3, pika 3.16 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, e lejojnë atë të ushtrojë veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor, me kusht që ajo t’i njoftojë këto organe për një person tjetër, që plotëson kërkesat e shkronjave “a” dhe “c” të pikës 1 të këtij kapitulli.

3. Plotësimi i kushtit në lidhje me reputacionin e mirë

3.1 Ndërmarrja konsiderohet me reputacion të mirë kur:

- a) Drejtuesi/drejtuesit e veprimtarisë së saj provojnë se nuk ka kryer shkelje në lidhje me:
 - i) rregullat që lidhen me kohën e drejtimit të mjetit dhe periudhat e pushimit të drejtuesve të mjeteve, kohën e punës; instalimin dhe përdorimin e pajisjes regjistruese;
 - ii) trajnimin e drejtuesve të mjeteve;
 - iii) mirëmbajtjen dhe kontrollin e detyrueshëm teknik, periodik e vjetor të mjeteve;
 - iv) rregullat e operimit në tregun e transportit të mallrave dhe udhëtarëve;
 - v) mbingarkimin e mjetit, duke kaluar në këtë mënyrë ngarkesën e lejuar sipas lejes së qarkullimit të tij;
 - vi) peshat dhe përmasat e mjeteve maksimale që përdoren në qarkullimin brenda vendit dhe atë ndërkombëtar;

vii) sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme me rrugë;

viii) instalimin dhe përdorimin e pajisjes së kufizimit të shpejtësisë në disa kategori mjete;

ix) lejen e drejtimit të mjetit;

x) mbrojtjen e mjedisit;

xi) drejtimin e mjetit nga drejtues nën efektin e lëndëve droguese ose psikotrope.

b) Drejtuesi/drejtuesit i veprimtarisë së saj nuk deklarohet i papërshtatshëm në kryerjen e veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor sipas pikës 4.1, të kapitullit III;

c) Ajo nuk ka qenë më parë e dënuar për shkelje serioze të rregullave në fuqi në lidhje me pagesat dhe kushtet e punës të drejtuesve të mjeteve profesionistë, trafikun rrugor, sigurinë rrugore, përgjegjësinë profesionale; ose

ç) Drejtuesi/drejtuesit i veprimtarisë së saj ka përfunduar periudhën e rehabilitimit, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 4.1, të këtij kapitulli.

3.2 Ndërmarrja, që kërkon të ushtrojë veprimtarinë e saj në transportin rrugor, dhe personat që janë caktuar në drejtimin e veprimtarisë së këtyre ndërmarrjeve, sipas pikës 2 të këtij kapitulli, duhet të deklarojnë në dokumentet e lëshuara, nga organet e transportit, se plotësojnë kushtin e reputacionit të mirë.

3.3 Organet e transportit janë të detyruara të verifikojnë deklaratën në plotësimin e kushtit të reputacionit të mirë për ndërmarrjen dhe drejtuesin e veprimtarisë së saj.

3.4 Në të njëjtën mënyrë gjykohet për reputacionin e mirë edhe në rast se masa të njëjta merren nga autoritetet përkatëse të shteteve të tjera, për shkeljet e kryera në territorin e këtyre shteteve, nga operatorët e transportit rrugor të mallrave.

3.5 Organet e transportit do të njohin një dokument të nxjerrë nga një regjistër juridik ose, në mungesë të tij, një dokument të lëshuar nga autoriteti gjyqësor ose administrativ në shtetin anëtar të BE-së, ku individi ose ndërmarrja e transportit është e vendosur.

3.6 Dokumentet e lëshuara sipas pikës 3.5 të këtij kapitulli janë të vlefshme brenda tre muajve nga data e lëshimit të tyre.

4. Rehabilitimi

4.1 Personat të cilët nuk përmbushin kërkesat e reputacionit të mirë sipas pikës 3 të këtij kapitulli, konsiderohen se e plotësojnë kushtin e reputacionit të mirë, kur këta persona kanë konsumuar një periudhë rehabilitimi:

a) 2-vjeçare, për shkelje sipas pikave (i) deri, dhe (x), të shkronjës “a” dhe shkronjës “b”, të pikës 3.1 të këtij kapitulli;

b) 10-vjeçare, për shkelje sipas pikës (xi) të shkronjës “a” të pikës 3.1 të këtij kapitulli.

4.2 Personat që kanë kryer periudhën e rehabilitimit, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 4.1 të këtij kapitulli, pas përfundimit të kësaj periudhe i nënshtrohen trajnimit dhe provimit të detyrueshëm, sipas pikave 6 deri në 8 të këtij kapitulli.

5. Plotësimi i kushtit për besueshmërinë financiare

5.1 Ndërmarrja duhet të garantojë se zotëron një kapital të mjaftueshëm për fillimin dhe administrimin e veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor.

5.2. Kërkesa për gjendje të besueshme financiare plotësohet kur disponohen burime të mjaftueshme financiare, të cilat garantojnë ecurinë dhe administrimin e ndërmarrjes së transportit.

Kur ndërmarrja bën kërkesë për licencë për të tretë ose me qira, organet e transportit pranojnë, në formën e një vërtetimi, konfirmimi nga banka ose institucioni tjetër të kualifikuar, vlerësimin e gjendjes financiare (bilancin vjetor të ndërmarrjes; fondet që ajo disponon, përfshirë depozitat bankare; kreditë dhe huatë lehtësuese; asetet, duke përfshirë pronat të cilat ndërmarrja mund t'i lërë peng si garanci; kostot, duke përfshirë koston e blerjes ose pagesën fillestare të mjetit; makineri - pajisjet dhe kapitalin punues).

5.3 Ndërmarrja duhet të ketë kapital të vlefshëm dhe rezervë, të paktën:

a) 4 000 euro për mjetin e parë dhe 2000 euro për çdo mjet shtesë, kur kryen transport ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve;

b) 30 000 lekë për mjetin e parë dhe 15 000 lekë për çdo mjet shtesë, kur kryen transport të mallrave dhe të udhëtarëve brenda vendit.

5.4 Standardi në lidhje me kapitalin minimal të vlefshëm dhe rezervë të gjendjes financiare të veprimtarisë së ndërmarrjes në transportin rrugor të brendshëm të mallrave dhe udhëtarëve do të unifikohet me atë të ndërmarrjes që ushtrojnë veprimtarinë e transportit rrugor ndërkombëtar, pesë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5.5 Organet e transportit do të pranojnë dokumente të lëshuara nga çdo bankë, institucion financiar ose institucione të ngarkuara për këtë qëllim në shtetin anëtar të BE-së, ku individi ose ndërmarrja e transportit rrugor ose filiali i saj është vendosur.

6. Plotësimi i kushtit në lidhje me kërkesën e kompetencës profesionale

6.1 Kompetenca profesionale plotësohet, në rastin kur personi që caktohet për drejtimin e veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor, në përputhje me pikën 2.1 të kapitullit II, zotëron njohuri të mjaftueshme, që i korrespondojnë nivelit të trajnimit në përputhje me programin bazë të parashikuar me udhëzim të ministrit. Kursi i trajnimit kryhet si për transportin e udhëtarëve, ashtu edhe për transportin e mallrave.

6.2 Kandidati, i cili dëshiron të ndjekë kursin për drejtues veprimtarie në ndërmarrjet e transportit rrugor, duhet të ketë mbaruar shkollën e mesme. Kursi i trajnimit është i detyrueshëm dhe më pas kandidati duhet të kryejë një provim të detyrueshëm, më shkrim dhe me gojë.

6.3 Provimi do të kryhet brenda periudhës 7-10 ditë nga dita e përfundimit të kursit që ka kryer kandidati. Instruktorët e trajnimit të jenë me nivel të lartë kualifikimi dhe miratohen nga ministri. Paga e kandidatëve për kursin e trajnimit caktohet me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë të Financave.

6.4 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor do të shërbejë si qendër në trajnimin e kandidatëve, që dëshirojnë të pajisen me certifikatën e kompetencës profesionale (ÇKP), për drejtues veprimtarie të ndërmarrjeve të transportit rrugor për mallra ose udhëtarë. Ministria ndjek nga afër veprimtarinë e kësaj qendre trajnimi në përgatitjen me kualitet të lartë të kandidatëve për drejtues

veprimtarie, në përputhje me programin bazë.

7. Zhvillimi i provimit

7.1 Certifikata e kompetencës profesionale lëshohet nga komisioni i vlerësimit të provimit, i cili organizohet në përputhje me udhëzimin e ministrit. Komisioni i provimit përbëhet nga tre persona, të cilët janë njohës të mirë të fushës së lëndëve të programit bazë të trajnimit.

7.2 Komisioni emërohet nga ministri dhe përbëhet nga kryetari, i cili është njëri nga specialistët e fushës së transportit rrugor dhe dy anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë dhe tjetri përfaqësues i shoqatave të transportit rrugor.

7.3 Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë dhe shoqatat e transportit rrugor, nëpërmjet asambleve të tyre respektive, zgjedhin disa përfaqësues, emrat e të cilëve ia bëjnë të ditur ministrit.

7.4 Provimi do të zhvillohet në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7.5 Kandidati do ta zhvillojë provimin me gojë vetëm pasi ai të ketë përmbushur pikët e nevojshme të provimit me shkrim, në përputhje me udhëzimin e ministrit.

7.6 Ministri, në përputhje me kërkesat e paraqitura nga kandidatët në ushtrimin e veprimtarisë së tyre në ndërmarrje, të cilat kanë lidhje me mbrojtjen e jetës, mbrojtjen e ambientit dhe të pasurisë, ligjet dhe aktet nënligjore që vlejnë në ushtrimin e veprimtarisë, nxjerr udhëzimin për sa i përket: fushës së provimit, formës së organizimit e kohëzgjatjen e provimit; kushteve që duhet të plotësojnë anëtarët e komisionit; lëshimit të certifikatës së kompetencës profesionale (ÇKP). Tarifa që duhet të paguhet nga kandidati për provimin, e cila i shërben shpenzimeve administrative dhe për shpërblimin e anëtarëve të komisionit të provimit, si dhe kushtet për kthimin e pagesës, në rast mospjesëmarrjeje në provim nga ana e kandidatit, caktohen me udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrit të Financave.

7.7 Ministri, rast pas rasti, ngre grupe pune të përbëra nga specialistë të fushës së transportit rrugor në ministri, në lidhje me administrimin në plotësimin e kushteve, për organizimin e provimit në përputhje me udhëzimin e tij.

7.8 Certifikata e kompetencës profesionale (ÇKP) e lëshuar nga organet e autorizuar sipas pikës 7.1 dhe 7.2 të këtij kapitulli, nuk është e transferueshme. Modeli, përmbajtja dhe plotësimi i certifikatës caktohet me udhëzim të Ministrit. Ajo u lëshohet kandidatëve, respektivisht sipas kursit të trajnimit e provimit që kanë kryer, veç për transportin e mallrave dhe veç për transportin e udhëtarëve. Certifikata e kompetencës profesionale lëshohet me afat pesëvjeçar.

8. Përfundimi nga trajnimi e provimi

8.1 Përfundohen nga trajnimi dhe provimi i detyrueshëm, për pjesën që janë diplomuar, të gjithë kandidatët, si inxhinierë mekanikë, ekonomistë ose juristë. Përfundohen nga trajnimi, por jo nga provimi, kandidatët, të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme dhe që sigurojnë dëshmi se pesë vitet e fundit kanë drejtuar pa ndërprerje veprimtarinë e një ndërmarrjeje të transportit rrugor.

8.2 Specialistët e ministrisë, që kanë mbuluar veprimtarinë e politikave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor, hyrjen në treg të ndërmarrjeve të transportit rrugor dhe monitorimin e këtij tregu, dhe që kanë të paktën në këto detyra mbi 3 vjet, përfundohen nga trajnimi i detyrueshëm dhe provimi për përfitimin e certifikatës së kompetencës profesionale (ÇKP).

8.3 Organet e transportit të licencimit do të njohin certifikatat e kompetencës profesionale, që lëshojnë organet e autorizuar sipas pikës 7.1 dhe 7.2 të këtij kapitulli, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8.4 Organet e transportit të licencimit do t'i njohin të gjitha certifikatat e kompetencës profesionale për shtetasit e zonës ekonomike të BE-së, por me kusht që kjo certifikatë të jetë e shoqëruar me një dokument shtesë, i cili dëshmon se personi ka ushtruar veprimtarinë e tij për tre vjet rresht pa ndërprerje në pesëvjeçarin e fundit.

KAPITULLI III

ORGANET E TRANSPORTIT, SHQYRTIMI DHE REGJISTRIMI I NDËRMARRJEVE

1. Organet e transportit

1.1 Kur në dispozitat e ligjit nr.8308, datë 18.3.1998, të ndryshuar, nuk është parashikuar organi i transportit, ato caktohen me udhëzim të ministrit, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji. Organet e transportit e ushtrojnë funksionin e tyre në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, e me dispozitat e këtij vendimi.

1.2 Organet e transportit, sipas ligjit nr.8308, datë 18.3.1998, të ndryshuar, në bashkëpunim me organet e kontrollit në rrugë, sipas nenit 11 dhe 12 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i

Republikës së Shqipërisë”, janë të detyruara të sigurojnë zbatimin e këtij vendimi.

1.3 Organet e transportit, në veprimtarinë e transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, në përputhje me pikën 1.1 të këtij kapitulli, kanë kompetenca, për sa i përket:

- a) shqyrtimit të kërkesave të bëra nga ndërmarrjet;
- b) dhënies së licencave, për të tretë ose me qira, brenda vendit dhe ndërkombëtare, si dhe lejes së përkohshme;
- c) deklarimit të një personi fizik të papërshtatshëm si drejtues të veprimtarisë së ndërmarrjes së transportit rrugor;
- ç) kryerjes së kontroleve të nevojshme për të verifikuar nëse ndërmarrja plotëson kërkesat e pikës 1 të kapitullit II.

2. Shqyrtimi dhe regjistrimi i ndërmarrjeve

2.1 Kërkesa për licencim në veprimtarinë e transportit rrugor, për të tretë ose me qira, për mallra ose udhëtarë, paraqitet pranë organit të transportit të licencimit, sipas pikës 1.1 të këtij kapitulli.

2.2 Ministria, me udhëzim, cakton të dhënat e nevojshme, që duhen për regjistrimin e një ndërmarrjeje nga organi i transportit, në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar.

2.3 Koha maksimale e lejuar për shqyrtimin e një kërkesë nga organi i transportit caktohet me udhëzim të ministrisë, në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar. Afati i shqyrtimit llogaritet nga data e regjistrimit të saj.

2.4 Nëse organi i transportit nuk ka marrë vendim në afatin e caktuar sipas pikës 2.3 të këtij kapitulli, ajo do të konsiderohet e pranuar.

2.5. Ndërmarrja, që e ushtron veprimtarinë në transportin rrugor, duhet, brenda 28 ditëve, të njoftojë organin e transportit, i cili e ka licencuar atë, për çdo ndryshim të të dhënave në pikën 2.2 të këtij kapitulli.

3. Deklarimi i papërshtatshmërisë së drejtuesit të veprimtarisë

3.1 Në rastin kur një ndërmarrjeje i është hequr licenca në ushtrimin e veprimtarisë së transportit, për shkak të:

- a) shkeljeve të përsëritura sipas shkronjës “a” të pikës 3.1 të kapitullit II; ose
- b) fshehjes së qëllimshme të shkeljeve të legjislacionit të transportit dhe dispozitave të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998, ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 vendimeve dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, organi i transportit deklaron menjëherë të papërshtatshëm edhe drejtuesin e veprimtarisë së ndërmarrjes.

3.2 Certifikata e kompetencës profesionale e personit të deklaruar të papërshtatshëm, sipas pikës 4.1 të këtij kapitulli, konsiderohet e pavlefshme për çdo rast, deri sa nuk është marrë një masë rehabilituese.

3.3 Organi i transportit njofton të gjitha institucionet e interesuara me të dhënat e personit, të cilit i është deklaruar e papërshtatshme certifikata e kompetencës profesionale.

4 Vendimet e organit të transportit

4.1 Organet e transportit refuzojnë kërkesën për licencim kur drejtuesi i veprimtarisë nuk ka plotësuar periudhën e rehabilitimit nga data kur është komunikuar dënimi ose kur dënohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, në përputhje me shkronjën “a” dhe “b” të pikës 3.1 të kapitullit II. Organet e transportit heqin licencën e një operatori të transportit rrugor në përputhje me nenin 8 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar.

4.2 Para marrjes së një vendimi, sipas pikës 5.1 të këtij kapitulli, për shkeljet e kryera nga ndërmarrja ose drejtuesi i veprimtarisë, organi i transportit, përveç organeve të kontrollit në rrugë sipas Kodit Rrugor, nëse është e nevojshme, grumbullon informacionin e duhur edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Inspektorati i Punës dhe institucionet e tjera, që ai konsideron të rëndësishme në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor.

4.3 Në aktin e refuzimit, organi i transportit arsyeton mbi shkaqet e refuzimit të licencimit të operatorit të transportit rrugor dhe të deklarimit të papërshtatshëm të drejtuesit të veprimtarisë. Organi i transportit specifikon arsyen e humbjes së reputacionit të mirë të drejtuesit të veprimtarisë, si dhe masën rehabilituese përkatëse, sipas pikës 4 të kapitullit II.

5. Ankimimi

Në rastin kur organi i transportit refuzon një kërkesë për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor, pezullon ose deklaron të papërshtatshëm për shkeljet e kryera nga ndërmarrja ose drejtuesi i veprimtarisë, ndërmarrja ose personi, që ka pësuar dënimin, ka të drejtë ta ankimojë vendimin e marrë nga organi i transportit, në bazë të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative

të Republikës së Shqipërisë”, si dhe për procedura të mëtejshme, ai mund të ankohet në rrugë gjyqësore, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

KAPITULLI IV BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

1. Krijimi i regjistrit elektronik kombëtar

1.1 Në zbatim të këtij vendimi krijohet regjistri elektronik kombëtar për ndërmarrjet e transportit rrugor, të cilat janë licencuar nga organet e transportit.

1.2 Regjistri elektronik kombëtar vendoset pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të dhënat që përmban regjistri elektronik kombëtar trajtohen dhe mbikëqyren vetëm nga personat përgjegjës të caktuar për këtë qëllim, në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

1.3 Informacioni i grumbulluar për ndërmarrjet e transportit rrugor nga organet e transportit dërgohet te Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila i hedh ato në regjistër.

1.4 Të drejtën e njohjes e kanë autoritetet përgjegjëse të licencimit, sipas pikës 1.1, kapitulli III dhe autoritetet e tjera që janë nën betim dhe që kanë kompetenca në lidhje me vëzhgimin dhe vendosjen e sanksioneve në fushën e transportit rrugor.

1.5 Regjistri elektronik kombëtar do të përmbajë të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) emrin dhe formën juridike të ndërmarrjes;
- b) adresën e vendosjes së saj;
- c) emrin e drejtuesit të veprimtarisë së transportit, i caktuar në plotësimin e kushteve, për sa i përket reputacionit të mirë dhe kompetencës profesionale dhe emrin e ortakëve të ndërmarrjes;
- ç) llojin e licencës për të tretë ose me qira dhe numrin e llojin e mjeteve, të shoqëruar me certifikata të operimit;
- d) numrin dhe llojin e shkeljeve, në mënyrë të veçantë ato të përmendura në pikën 3.1 të kapitullit II, në dy vitet e fundit;
- e) emrin e çdo personi të deklaruar të papërshtatshëm në veprimtarinë e transportit të një ndërmarrjeje në dy vitet e fundit dhe masat rehabilituese nëse ka.

1.6 Të dhënat në lidhje me një ndërmarrje, së cilës i është hequr licenca ose kur drejtuesi i veprimtarisë është deklaruar i papërshtatshëm, do të mbahen në regjistër për një periudhë dyvjeçare. Të dhënat duhet të shoqërohen në regjistër me arsyet e heqjes të licencës ose deklarimin e papërshtatshmërisë së drejtuesit të veprimtarisë.

1.7 Të gjitha të dhënat, që përmbahen në regjistër, duhet të përditësohen në vazhdimësi.

1.8 Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të marrë masat për ngritjen e regjistrit elektronik kombëtar deri më 31 dhjetor 2012.

2. Shkëmbimi i informacionit

2.1 Drejtoritë, të cilat mbulojnë transportin dhe qarkullimin rrugor, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor pranë MPPTT janë pika kontakti për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm me shtetet e tjera në lidhje me ndërmarrjet e transportit rrugor të vendosura në Shqipëri në zbatim të këtij vendimi.

2.2 Në rastin kur një operator transporti rrugor jorezident, që ka kryer shkelje, serioziteti i të cilave çon në heqjen e licencës në zbatim të këtij vendimi, pikat e kontaktit, sipas pikës 2.1 të këtij kapitulli, do t'i komunikojnë autoriteteve përgjegjëse të shtetit tjetër, të regjistrimit të operatorit të transportit rrugor, të gjithë informacionin që zotërojnë, si edhe për shkeljet dhe masat ndëshkimore që janë marrë ndaj tij, të cilat së bashku do të regjistrohen në përputhje me pikën 1.6 të këtij kapitulli.

KAPITULLI V RUAJTJA E TË DREJTAVE

1. Të drejtat

1.1 Licencat sipas paragrafit të parë, të shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2.1 të kapitullit I, të cilat janë lëshuar para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të mbeten të vlefshme deri në datën, për të cilën janë lëshuar.

1.2 Kërkesat për licencim për fillimin ose vazhdimin e një biznesi transporti, të cilat janë paraqitur para kohës, në të cilën ky vendim ka hyrë në fuqi, do të trajtohen në përputhje me dispozitat e këtij vendimi, për aq sa për ato nuk janë marrë vendime, kur ky akt hyn në fuqi.

1.3 Ndërmarrjet, të cilat kanë qenë të licencuara si operator i transportit rrugor, për të tretë ose me qira të mallrave ose udhëtarëve, brenda vendit ose ndërkombëtar, para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të pajtohen me dispozitat e këtij vendimi jo më vonë se dy vjet pas datës së hyrjes në fuqi.

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave të nxjerrin e aktet nënligjore brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Tabela 1 e përputhshmërisë

1. Direktiva e Këshillit 96/26/EC e 29 prillit 1996 “Për pranimin në aktivitetin e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe njohjen reciproke të diplomave, certifikatave dhe evidencave të tjera të kualifikimeve zyrtare të caktuara për lehtësimin për këta operatorë të drejtën e lirisë së vendosjes në operacionet e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar”, botuar në Fletoren Zyrtare L.124, datë 23.5.1996, faqe 1, e amenduar nga direktiva 98/76/EC botuar në Fletoren Zyrtare L.277, datë 14.10.1998, faqe 17, amenduar nga direktiva 2004/66/EC, botuar në Fletoren Zyrtare L.168, datë 1.5.2004, faqe 33. Direktiva ka për qëllim unifikimin e kriterëve cilësorë që duhet të zbatohen nga të gjitha shtetet anëtare për pranimin në aktivitetin e operatorit të transportit rrugor, lirinë e vendosjes në ushtrimin e aktivitetit dhe njohjen reciproke të certifikatave të kualifikimit të drejtuesve të veprimtarive të këtyre operatorëve. Zbatimi i të gjitha detyrimeve që shpreh direktiva 96/26/EC janë objekt i ndryshimit të legjislacionit të vendit me qëllim krijimin e këtyre standardeve cilësore për operatorët e transportit shqiptar për t'u krijuar atyre akses të njëjtë në treg me operatorët e KE-së. 2. Projektvendimi “Për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe njohja e dokumenteve të caktuara për këta operatorë” është një akt ligjor i plotë për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor, i cili buron nga ligji nr.8308, datë 22.7.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar. Projektvendimi, sipas MSA, është në përputhje me direktivën 96/26/KE, e amenduar nga direktiva 98/76/EC botuar në Fletoren Zyrtare L.277, datë 14.10.1998, faqe 17, amenduar nga direktiva 200/66/EC, botuar në Fletoren Zyrtare L.168, datë 1.5.2004, faqe 33.				
3. Ndryshimet që janë parashikuar të kryhen në projektvendim e përafrojnë atë pjesërisht me këtë direktivë. Shkalla e përafrimit, e pjesshme.				
Direktiva 96/26/KE				
a) Nenet dhe pjesë të legjislacionit të direktivës 96/26/KE-së	b) Parashikimet e projektaktit	c) Përputhja e projektaktit me legjislacionin e BE-së (i plotë; i pjesshëm; jo i aplikueshëm)	d) Arsytet për përputhje të pjesshme	e) Periudha e parashikuar për përputhje të plotë
Neni 2, pika 1	Kapitulli I, pika 1.2, shkronja “b”.	E plotë		
Neni 2, pika 2, shkronja “a”, paragrafi i parë.	Kapitulli I, pika 3.2, 3.3, 3.4 dhe 3.5	E pjesshme	Në përputhje me nenin 44 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar	
Neni 2, pika 2, shkronja “b”				
Neni 2, pika 3	Kapitulli I, pika 3.6	E plotë		
Neni 3, pika 1	Kapitulli II, pika 1. Kërkesat që duhet të plotësohen për licencimin e operatorit të transportit rrugor	E plotë		
Neni 3, pika 1, paragrafi i dytë	Kapitulli II, pika 2.2 Kërkesat ndaj caktimit të drejtuesit të veprimtarisë së transportit në ndërmarrje kur është person fizik	E pjesshme		
Neni 3, pika 1, paragrafi i tretë. Kur kandidati nuk është person fizik	Kapitulli II, pika 2.1 Kërkesat ndaj caktimit të drejtuesit të veprimtarisë së transportit në ndërmarrje			
Neni 3, pika 2	Kapitulli II, pika 3. Kushtet që duhet të plotësojë ndërmarrja për reputacionin e mirë	E plotë		
Neni 3, pika 2, paragrafi i fundit	Kapitulli II, pika 4. Rehabilitimi në rastin e shlyerjes së një dënimi për fillimin e veprimtarisë	E plotë		
Neni 3, pika 3, shkronja “a”	Kapitulli II, pika 5.1. Plotësimi i kërkesave për gjendjen financiare	E plotë		
Neni 3, pika 3, shkronja “b”	Kapitulli II, pika 5.2	E plotë		
Neni 3, pika 3, shkronja “c”	Kapitulli II, pika 5.3	E pjesshme		
Neni 3, pika 3, shkronja “d”	Kapitulli II, pika 5.2	E plotë		
Neni 3, pika 4, shkronja “a”	Kapitulli II, pika 6.1, 6.2, 6.3 dhe 7. Plotësimi i	E plotë		

	kërkesave për kompetencën profesionale			
Neni 3, pika 4, shkronja “b” dhe c”	Kapitulli II, pika 8.1, 8.2	E plotë		
Neni 3, pika 4, shkronja “d”	Kapitulli II, pika 7.8	E plotë		
Neni 4, paragrafi i parë	Kapitulli III, pika 3.2 dhe 3.3. Procedura për lajmërimin dhe procedura për heqjen e licencës dhe deklarimi i papërshtatshëm i drejtuesit të veprimtarisë	E pjesshme		
Neni 4, paragrafi i dytë		Nuk përputhet		
Neni 5, pika 3	Kapitulli II, pika 5.3 dhe 5.4	E plotë		
Neni 6, pika 1	Kapitulli III, pika 5.1 dhe 5.3. Refuzimi i një kërkesë për licencimin si operator në transportin e mallrave për të tretë	E pjesshme		
Neni 6, pika 1 paragrafi i dytë dhe i tretë. Kontrollët	Kapitulli III, shkronja “c” e pikës 3.2	E pjesshme		
Neni 6, pika 2		E pjesshme (përputhet pjesërisht me ligjin nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, neni 64, 65 dhe 67, të kreut VI		
Neni 6, pika 3	Kapitulli III, pika 7 Ankimi	E plotë		
Neni 7	Kapitulli IV, pika 2. Autoritetet e ngarkuara për shkëmbimin e informacionit me shtetet e tjera në lidhje me kundërvajtjet e transportuesve jorezident	E plotë		
Neni 8, pika 2	Kapitulli II, pika 3.7	E pjesshme		
Neni 8, pika 5	Kapitulli II, pika 3.8	E plotë		
Neni 9	Kapitulli II, pika 5.5	E plotë		
Neni 10, pika 1 dhe 2	Kapitulli II, pika 8.4	E pjesshme		
Neni 10 a		Nuk përputhet		
Neni 10 b	Kapitulli II, pika 8.4	E plotë		
Neni 11	Kapitulli II, pika 3.4 , 5.2 dhe 7.2	E plotë		
Neni 12				
Neni 13				
Neni 14				
Aneksi I	Aneksi 1	E plotë		
Aneksi II	Aneksi 2	E plotë		
Aneksi Ia	Aneksi 3	E plotë		

Tabela 2 e përputhshmërisë

1. Projektvendimi “Për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve” është një akti ligjor i plotë për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor, i cili

buron nga ligji nr.8308, datë 22.7.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar. Projektvendimi, sipas MSA, është në përputhje me direktivën 96/26/KE, e amenduar nga direktiva 98/76/EC, botuar në Fletoren Zyrtare L.277, datë 14.10.1998, faqe 17, amenduar nga direktiva 2004/66/EC, botuar në Fletoren Zyrtare L.168, datë 1.5.2004, faqe 33.				
2. Direktiva e Këshillit 96/26/EC e 29 prillit 1996 “Për pranimin në aktivitetin e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe njohjen reciproke të diplomave, certifikatave dhe evidencave të tjera të kualifikimeve zyrtare të caktuara për lehtësimin për këta operatorë të drejtën e lirisë së vendosjes në operacionet e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar”, botuar në Fletoren Zyrtare L.124, datë 23.5.1996, faqe 1, e amenduar nga direktiva 98/76/EC botuar në Fletoren Zyrtare L.277, datë 14.10.1998, faqe 17, amenduar nga direktiva 2004/66/EC, botuar në Fletoren Zyrtare L.168, datë 1.5.2004, faqe 33. Direktiva ka për qëllim unifikimin e kriterëve cilësorë që duhet të zbatohen nga të gjitha shtetet anëtare për pranimin në aktivitetin e operatorit të transportit rrugor, lirinë e vendosjes në ushtrimin e aktivitetit dhe njohjen reciproke të certifikatave të kualifikimit të drejtuesve të veprimtarive të këtyre operatorëve. Zbatimi i të gjitha detyrimeve që shpreh direktiva 96/26/EC janë objekt i ndryshimit të legjislacionit.				
3. Ndryshimet që janë parashikuar të kryhen në projektvendim e përfaqësojnë atë pjesërisht me këtë direktivë. Projektvendimi “Për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe njohja e dokumenteve të caktuara për këta operatorë”.				
a)	b)	c)	d)	e)
Parashikimet e projektaktit	Pjesë të legjislacionit të direktivës 96/26/KE-së që përfaqësohen	Përputhja e projektaktit me legjislacionin e BE-së (i plotë; i pjesshëm, jo i aplikueshëm)		
Kapitulli I, pika 1.2, shkronja “b”	Neni 2, pika 1	E plotë		
Kapitulli I, pika 3.2, 3.3, 3.4 dhe 3.5	Neni 2, pika 2, shkronja “a”, paragrafi i parë	E pjesshme		
Kapitulli I, pika 3.6	Neni 2, pika 3	E plotë		
Kapitulli II, pika 1. Kërkesat që duhet të plotësohen për licencimin e operatorit të transportit rrugor	Neni 3, pika 1	E plotë		
Kapitulli II, pika 2.1. Kërkesat ndaj caktimit të drejtuesit të veprimtarisë së transportit në ndërmarrje	Neni 3, pika 1, paragrafi tretë, kur ndërmarrja nuk është person fizik	E pjesshme		
Kapitulli II, pika 2.2. Kërkesat ndaj caktimit të drejtuesit të veprimtarisë së transportit në ndërmarrje	Neni 3, pika 1, është person fizik	E pjesshme		
Kapitulli II, pika 3. Kushtet që duhet të plotësojë ndërmarrja për reputacionin e mirë	Neni 3, pika 2	E plotë		
Kapitulli II, pika 3.7 dhe 3.8	Neni 8, pika 2, 3 dhe 5	E plotë		
Kapitulli II, pika 4. Rehabilitimi në rastin e shlyerjes së një dënimi për fillimin e veprimtarisë	Neni 3, pika 2, paragrafi i fundit	E plotë		
Kapitulli II, pika 5. Plotësimi i kërkesave për gjendjen financiare	Neni 3, pika 3, shkronja “a”	E plotë		
Kapitulli II, pika 5.2	Neni 3, pika 3, shkronja “b”	E plotë		
Kapitulli II, pika 5.3	Neni 3, pika 3, shkronja “c”	E pjesshme		
Kapitulli II, pika 5.2	Neni 3, pika 3, shkronja “d”	E plotë		
Kapitulli II, pika 6.1, 6.2, 6.3 dhe 7. Plotësimi i kërkesave për kompetencën profesionale	Neni 3, pika 4, shkronja “a”	E plotë		
Kapitulli II, pika 8.1, 8.2	Neni 3, pika 4, shkronja “b” dhe “c”	E plotë		
Kapitulli II, pika 7.8	Neni 3, pika 4, shkronja “d”	E plotë		
Kapitulli III, pika 4.2 dhe 4.3. Procedura për	Neni 4, paragrafi i parë	E pjesshme		

lajmërimin dhe procedura për heqjen e licencës dhe deklarimi i papërshtatshëm i drejtuesit të veprimtarisë				
	Neni 4, paragrafi i dytë	Nuk përputhet		
Kapitulli II, pika 5.3 dhe 5.4	Neni 5, pika 3	E plotë		
Kapitulli II, pika 3.7	Neni 8, pika 2 dhe 3	E pjesshme		
Kapitulli II, 5.5	Neni 9	E plotë		
Kapitulli II, pika 8.4	Neni 10 b	E pjesshme		
Kapitulli II, pika 8.4	Neni 10, pika 1 dhe 2	E pjesshme		
Kapitulli II, pika 3.4, 5.2 dhe 7.2	Neni 11	E plotë		
Kapitulli III, pika 5.1 dhe 5.3. Refuzimi i një kërkesë për licencimin si operator në transportin e mallrave për të tretë	Neni 6, pika 1	E pjesshme		
Kapitulli III, pika 3.2 dhe 3.3	Neni 6, pika 2	E plotë		
Kapitulli III, pika 6. Ankimimi	Neni 6, pika 3	E plotë		
Kapitulli IV, pika 2. Autoritetet e ngarkuara për shkëmbimin e informacionit me shtetet e tjera në lidhje me kundërvajtjet e transportuesve jorezidentë	Neni 7	E plotë		
Kapitulli IV, pika 1. Regjistri elektronik		Nuk ka përputhje		
Aneksi 1	Aneksi I	E plotë		
Aneksi 2	Aneksi II	E plotë		
Aneksi 3	Aneksi Ia	E plotë		

VENDIM
Nr.326, datë 19.3.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA KOZARË TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Kozarë të qarkut të Beratit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kozarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Komuna Kozarë										
Nr. rendor	Numri i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyje dhe kullosore (EPK) Shtrirja gjeografike	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	622	Mali i Kozares	Gropa e Moves	11a	p/p Shk	14.5	Dru zjarri	M.M.P.A.U	Komuna	
2	623	“	Përroi i Llixhës	12a	p/pShk	3.34	Dru zjarri	“	“	
3	624	“	Shulleri	13a	p/pCu	6	Dru zjarri	“	“	
4	625	“	Bregu	14a	p/pShk	15.19	Dru zjarri	“	“	
5	626	“	Dushku	14b	p/pcu	3.1	Dru zjarri	“	“	
6	627	“	Mbi Kullenjtë	15a	p/pshk	16.43	Dru zjarri	“	“	
7	628	“	Mbi Kullenjtë	15b	p/pcu	2	Lpun.dru	“	“	
8	635	“	Brahimllarët	21a	p.pcu	9.7	Dru zjarri	“	“	
9	636	“	Zhavalina	22a	p.pcu	6.4	Dru zjarri	“	“	
10	637	“	Zhavalina	23a	p.pcu	19.53	Dru zjarri	“	“	
11	638	“	Bliri	24a	p.pcu	12.09	Dru zjarri	“	“	
12	639	“	Bliri	25a	P.p.shk	26.04	Dru zjarri	“	“	
13	640	“	Plepi Frashër	26a	Sb pyjore	4.4	Dru zjarri	“	“	
14	651	“	Frashëri	72a	Sip/boshe	12.6	Sip boshe	“	“	
15	652	“	Frashëri	72b	Sip boshe	14	Sip boshe	“	“	
16	653	“	Frashëri	72c	Sip boshe	20	Sip boshe	“	“	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
622-628	Pyll+Sip të tjera	Në pronësi
635-640	Pyll+Sip të tjera	Në pronësi
651-653	Pyll+Sip të tjera	Në pronësi

VENDIM
Nr.327, datë 19.3.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA MARGEGAJ TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Margegaj të qarkut të Kukësit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 4 (katër) fletë, që përfundon me numrin rendor 113 (njëqind e trembëdhjetë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Margegaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i Pushtetit Qendror: MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

Komuna: **Margegaj**

Fusha e përdorimit të pronës: Pyje, kullota etj.

Nr. rend.	Nr. Inv sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullimore (EPK)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi Juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	907	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	88a	Pyll Prodhues	22.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
2	908	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	88b	Shkembe	7.25		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
3	909	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	88c	Livadhe	4.5	Kullotje	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
4	910	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	89a	Pyll Prodhues	38	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
5	911	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	90	Shkembe	25.25		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
6	912	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	91a	Pyll Prodhues	35.75	LP+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
7	913	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	91b	Livadhe	4.7	Kullotje	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
8	914	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	91c	Shkembe	17.75		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
9	915	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	91d	Pyll Prodhues	6.5	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
10	916	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	92a	Pyll Mbrojtes	10	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
11	917	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	92b	Shkembe	20.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
12	918	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	93a	Pyll Prodhues	39.75	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
13	919	Lugina e Kolgecaje	Bisheve	93c	Shkembe	20.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	
14	450	Çerem - Dragobi	Shpati i Kamishit	1a	Pyll Mbrojtes	23	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
15	451	Çerem - Dragobi	Shpati i Kamishit	1b	Livadhe	3.25	Kullotje	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
16	452	Çerem - Dragobi	Shpati i Kamishit	1c	Shkembe	1.75	Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
17	453	Çerem - Dragobi	Shpati i Gracit	2a	Pyll Mbrojtes	25.75	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
18	454	Çerem - Dragobi	Shpati i Gracit	2c	Shkembe	2.75		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
19	455	Çerem - Dragobi	Shpati i Gracit	3a	Pyll Mbrojtes	22.5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
20	456	Çerem - Dragobi	Shpati i Gracit	4a	Pyll Mbrojtes	53	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar

21	457	Çerem - Dragobi	Shpati i Gracit	4b	Livadhe	6	Kullotje	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
22	458	Çerem - Dragobi	Shpati i Gracit	4c	Shkembe	6.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
23	459	Çerem - Dragobi	Shpati i Gracit	5a	Pyll Mbrojtes	29	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
24	460	Çerem - Dragobi	Shpati i Gracit	5c	Shkembe	3		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
25	461	Çerem - Dragobi	Maja e Sh.Gracit	6a	Pyll Mbrojtes	34.5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
26	462	Çerem - Dragobi	Maja e Sh.Gracit	6b	Sip.Inprodukt	16		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
27	463	Çerem - Dragobi	Kepi i Gracit	7a	Sip.Shkembore	11		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
28	464	Çerem - Dragobi	Kepi i Gracit	7b	Sip.Shkembore	32		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
29	465	Çerem - Dragobi	Kepi i Gracit	8a	Sip.Shkembore	37.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
30	466	Çerem - Dragobi	Kepi i Gracit	8b	Sip.Shkembore	8		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
31	467	Çerem - Dragobi	Kepi i Gracit	9a	Sip.Shkembore	21.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
32	468	Çerem - Dragobi	Kepi i Gracit	9b	Shkembe	4.75		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
33	469	Çerem - Dragobi	Glysur	10a	Pyll Mbrojtes	5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
34	470	Çerem - Dragobi	Glysur	10b	Shkembe	17		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
35	471	Çerem - Dragobi	Glysur	10c	Shkembe	5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
36	472	Çerem - Dragobi	Glysur	11a	Pyll Mbrojtes	19	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
37	473	Çerem - Dragobi	Glysur	11b	Shkembe	14.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
38	474	Çerem - Dragobi	Glysur	11c	Shkembe	16.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
39	475	Çerem - Dragobi	Glysur	11d	Sip.Inprodukt	5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
40	476	Çerem - Dragobi	Glysur	12a	Pyll Mbrojtes	4	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
41	477	Çerem - Dragobi	Glysur	12b	Shkembe	28.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
42	478	Çerem - Dragobi	Glysur	12c	Shkembe	3.75		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
43	479	Çerem - Dragobi	Glysur	12d	Sip.Inprodukt	1		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
44	480	Çerem - Dragobi	Glysur	13a	Pyll Mbrojtes	2	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
45	481	Çerem - Dragobi	Glysur	13b	Shkembe	24.25		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
46	482	Çerem - Dragobi	Glysur	13c	Shkembe	4.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
47	483	Çerem - Dragobi	Glysur	13d	Sip.Inprodukt	0.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
48	484	Çerem - Dragobi	Glysur	14a	Pyll Mbrojtes	8.5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
49	485	Çerem - Dragobi	Glysur	14b	Shkembe	15.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
50	486	Çerem - Dragobi	Glysur	14c	Shkembe	8		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
51	487	Çerem - Dragobi	Glysur	14d	Sip.Inprodukt	3		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
52	488	Çerem - Dragobi	Glysur	15	Shkembe	15		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
53	489	Çerem - Dragobi	Glysur	16a	Pyll Mbrojtes	14.5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
54	490	Çerem - Dragobi	Glysur	16b	Shkembe	21.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar

55	491	Çerem - Dragobi	Glysur	16c	Shkembe	7		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
56	492	Çerem - Dragobi	Glysur	16d	Sip.Inprodukt	3		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
57	493	Çerem - Dragobi	Glysur	17a	Pyll Mbrojtes	21.5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
58	494	Çerem - Dragobi	Glysur	17b	Shkembe	12		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
59	495	Çerem - Dragobi	Glysur	17c	Shkembe	5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
60	496	Çerem - Dragobi	Glysur	18a	Shkembe	25.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
61	497	Çerem - Dragobi	Glysur	18b	Shkembe	3.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
62	498	Çerem - Dragobi	Glysur	19a	Shkembe	26		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
63	499	Çerem - Dragobi	Glysur	19b	Shkembe	4.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
64	500	Çerem - Dragobi	Glysur	20a	Pyll Mbrojtes	21.5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
65	501	Çerem - Dragobi	Glysur	20b	Shkembe	2		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
66	502	Çerem - Dragobi	Glysur	21a	Pyll Mbrojtes	25	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
67	503	Çerem - Dragobi	Glysur	21b	Sip. Shkembore	3.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
68	504	Çerem - Dragobi	Glysur	22a	Pyll Mbrojtes	17	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
69	505	Çerem - Dragobi	Glysur	22b	Sip. Shkembore	15.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
70	506	Çerem - Dragobi	Glysur	22c	Sip. Shkembore	4.75		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
71	507	Çerem - Dragobi	Glysur	23a	Pyll Mbrojtes	22.5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
72	508	Çerem - Dragobi	Glysur	23b	Shkembe	2.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
73	560	Çerem - Dragobi	Shpati i Petishit	46a	Pyll Mbrojtes	26.5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
74	561	Çerem - Dragobi	Shpati i Petishit	46b	Pyll Mbrojtes	5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
75	564	Çerem - Dragobi	Shpati i Dragobise	49a	Pyll Mbrojtes	32.5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
76	565	Çerem - Dragobi	Shpati i Dragobise	49b	Shkembe	0.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
77	566	Çerem - Dragobi	Shpati i Dragobise	50a	Pyll Mbrojtes	11	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
78	567	Çerem - Dragobi	Shpati i Dragobise	50b	Pyll Mbrojtes	20	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
79	568	Çerem - Dragobi	Shpati i Dragobise	50c	Shkembe	1		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
80	569	Çerem - Dragobi	Shpati i Sinopatit	51a	Pyll Mbrojtes	13	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
81	570	Çerem - Dragobi	Shpati i Sinopatit	51b	Pyll Mbrojtes	16	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
82	571	Çerem - Dragobi	Shpati i Sinopatit	51c	Shkembe	16		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
83	572	Çerem - Dragobi	Shpati i Sinopatit	52	Pyll Mbrojtes	25.5	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
84	163	Valbone - Çerem	Shkolla e Rrogamit	5c	Pyll Mbrojtes	8.25	Mbrojt. Toke	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
85	165	Valbone - Çerem	Fshati Gjellaj	6b	Livadhe	6.25	Kullotje	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
86	167	Valbone - Çerem	Fshati Gjellaj	7b	Kullote	3.5	Kullotje	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
87	169	Valbone - Çerem	Rrogam	9c	Shkembe	3		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
88	173	Valbone - Çerem	Rrogam	10d	Sip.Eroduar	26.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar

89	184	Valbone - Çerem	Llomi i Mehmetit	15b	Sip.Boshe	38.75		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
90	185	Valbone - Çerem	Llomi i Mehmetit	15c	Livadhe	1.75	Kullotje	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
91	186	Valbone - Çerem	Llomi i Mehmetit	15d	Shkembe	2.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
92	188	Valbone - Çerem	Rrogam	16b	Sip.Boshe	9.25		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
93	189	Valbone - Çerem	Rrogam	16c	Shkembe	5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
94	190	Valbone - Çerem	Llomi i Mehmetit	17a	Livadhe	21	Kullotje	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
95	195	Valbone - Çerem	Buni i Balkines	19a	Pyll Prodhues	7.5	L.P+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
96	202	Valbone - Çerem	Maja e Rrogamit	20c	Kullote	9.25	Kullotje	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
97	203	Valbone - Çerem	Maja e Rrogamit	20d	Shkembe	5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
98	270	Valbone - Çerem	Kukaj	41b	Pyll Prodhues	13	L.P+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
99	271	Valbone - Çerem	Kukaj	41c	Pyll Prodhues	9.75	L.P+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
100	274	Valbone - Çerem	Valbone	42c	Pyll Prodhues	9.5	L.P+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
101	285	Valbone - Çerem	Maja e Thate	46a	Pyll Prodhues	15	L.P+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
102	287	Valbone - Çerem	Valbone	47a	Pyll Prodhues	21.5	L.P+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
103	288	Valbone - Çerem	Valbone	47b	Sip.Boshe	11.5		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
104	289	Valbone - Çerem	Valbone	47c	Shkembe	31.25		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
105	291	Valbone - Çerem	Valbone	49a	Pyll Prodhues	17.5	L.P+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
106	293	Valbone - Çerem	Valbone	50a	Pyll Prodhues	4.25	L.P+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
107	319	Valbone - Çerem	Mijushi i Ali Zekes	62b	Pyll Prodhues	12	L.P+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
108	320	Valbone - Çerem	Mijushi i Ali Zekes	62c	Pyll Prodhues	6	L.P+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
109	321	Valbone - Çerem	Mijushi i Ali Zekes	62d	Sip.Boshe	7.25		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
110	323	Valbone - Çerem	Mijusha e Sjapices	63b	Pyll Prodhues	15.25	L.P+Dru Zjarri	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
111	324	Valbone - Çerem	Mijusha e Sjapices	63c	Kullote	7.25	Kullotje	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
112	325	Valbone - Çerem	Mijusha e Sjapices	63d	Shkembe	5.25		M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar
113	335	Valbone - Çerem	Prroi i Derzhanes	64f	Kullote	4.5	Kullotje	M.M.P.A.U	Komuna Margegaj	Park Kombetar

Numrat rendore të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
163,165,167,169,173,184-186 188-190,195,202-203,270-271 274,285,287-289,291,293 319-321,323-325,335,450-561 564-572,907-919	Pyll, kullotë etj.	Pronësi

VENDIM
Nr.328, datë 19.3.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA QENDËR MALËSI E MADHE TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Qendër Malësi e Madhe të qarkut të Shkodrës, që do t'i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 11 (njëmbëdhjetë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qendër Malësi e Madhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota,livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Komuna: Qendër Malësi e Madhe										
Nr. rendor	Numri i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK).Shtrirja gjeografike	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	102	Ek.Pyjore “Koplik Grumierë”	Bregu i Liqenit	1	Pyll Prodhues	13,8	Prodhim thupër	MMPAU	Komuna	
2	103	“	Koplik	2a	S.boshe	7.5	Kullotë	“	“	
3	104	“	Koplik	2b	S.boshe	4,5	Kullotë	“	“	
4	105	“	Selvija Koplik	2c	S.boshe	2,0	Kullotë	“	“	
5	106	“	Përroi i thatë	3a	S.boshe	3,5	Kullotë	“	“	
6	107	“	Përroi i thatë	3b	Pyll prodhues	9,5	Dru zjarri	“	“	
7	108	“	Përroi i thatë	3c	S.boshe	11,0	Kullotë	“	“	
8	109	“	Përroi i thatë	4a	S.boshe	21,3	Kullotë	“	“	
9	110	“	Përroi i thatë	4b	S.boshe	6,0	Kullotë	“	“	
10	111	“	Përroi i Shojsë	8	Pyll prodhues	6,5	Dru zjarri	“	“	
11	112	“	Përroi Banishit	9	Pyll prodhues	35.5	Dru zjarri	“	“	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
102-112	Pyll dhe sipërfaqe të tjera	Në pronësi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 9.4.2008
 Doli nga shtypi më 11.4.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
 Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë